

Delegacionet e nivelit të lartë të Serbisë dhe Kosovës i mbajtën bisedimet e para për statusin në Vjenë

Vjenë – Delegacionet e nivelit të lartë të Serbisë dhe Kosovës u takuan sot në Vjenë nën udhëheqjen e Emisarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, z. Martti Ahtisaari. Delegacionin e Beogradit e udhëhoqën kryetari Boris Tadiq dhe kryeministri Vojislav Koshtunica kurse ekipin e bashkuar të Prishtinës e udhëhoqi kryetari Fatmir Sejdiu.

Emisari Special në takimin për media tha se: “takimi i nivelit të lartë që posa u mbajt është një rezultat i dëshirës së qartë të palëve për t’i filluar bisedimet e drejtpërdrejta për statusin e ardhshëm” dhe shtoi se: “si takim i parë i këtij lloji, diskutimi i ditës së sotme është menduar t’u mundësojë të dyja palëve që të paraqesin dhe argumentojnë pozitat e tyre përkatëse, prandaj takimi e ka arritur këtë objektiv”.

Z. Ahtisaari tha se prezentimi tregoi se “është e qartë që pozitat e palëve mbeten shumë larg: Beogradi do të pajtohej për gati çdo gjë tjetër përveç pavarësisë kurse Prishtina nuk do të pranonte asgjë përveç pavarësisë”.

“Ne jemi të gatshëm të ndihmojmë dialogun në rafshin politik” tha Emisari Special dhe shtoi se “a do të sjellin këto bisedime çfarëdo marrëveshje në fund të fundit varet nga vullneti dhe gatishmëria e palëve”.

Z. Ahtisaari shprehu qëllimin e UNOSEK-ut për të lëvizur shpejt përpara me diskutimet e mëtejme në aspektin teknik. Ai tha se “ndonëse përparimi ka qenë i pabarabartë, këto bisedime na kanë siguruar bazën se si të vazhdohet me shkuarjen përpara. “Emisari Special vazhdoi të thotë se diskutimet duhet të përqendrohen në masë të madhe në fushat të cilat nuk janë diskutuar – përkatësisht në të drejtat e komunitetit dhe aspektet kushtetuese dhe institucionale të procesit të statusit. Z. Ahtisaari i ftoi të dyja palët që të jenë “reale dhe fleksibile” në mënyrë që të arrihet përparim thelbësor në këto fusha.

Z. Ahtisari rikujtoi që njëri prej qëllimeve qendrore i komunitetit ndërkombëtar është që të krijojnë kushtet në Kosovë ku të gjitha komunitetet mund të jetojnë në një shoqëri shumetnike. Për krijimin e kushteve të tilla, mbështetja e plotë e Serbisë është e një rëndësia vitale. Nuk është e mundur të krijohen kushtet e duhura nëse Beogradi refuzon të bashkëpunojë për këtë çështje.

Emisari Special tha se i ka perkujtuar pjesemarrësit e këtij takimi të nivelit të lartë se procesi i tanishëm është për të gjithë popullin e Kosovës nga të gjitha komunitetet e Kosovës. Ai tha se “njerëzit presin që ata të ushtrojnë udhëheqësinë e tyre dhe të njëjtën gjë e pret edhe komuniteti ndërkombëtar”. Në këtë kontekst, ai mirëpriti deklaratën e fundit të Grupit të Kontaktit të dhënë në takim in e nivelit të lartë.